



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR POGRADEC

Pogradec me 15/Maj /2024

Nr. ____ Prot.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje dhe instalim i pajisjeve mjeksore per nevoja te Drejtorise se Sherbimit Spitalor Pogradec.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

MALLRA, Kodet CPV : - 33100000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,928,333 leke(dhjetemilionenenteqindendjetetetemijetreqindetridh-dhjetetre)lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,te ndyshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor “**Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec**”ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Shenim:Operatori ekonomik i renditur i pari me njohjen e renditjes nepermjet SPE-se dhe perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit duhet te dorezoje dokumentat provuese te parashikuara ne shkronjat a,b,d,dh,e,h,i,j te pikes 2, ne nenit 26, te VKM-se 285 /2021 “ Rregullat e Prokurimit Publik”,si dhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike.Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njehesuar me origjinalin.

a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbeshtetje ne nenin 82, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe nenin 26, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së e ndryshuar, dhe në këto rregulla."

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te nenit 30, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" si dhe ne nenin 83, te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës
- b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a) Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale per tregetim te pajisjeve mjekesore te vlefshme .

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1/a dhe 2, te nenit 77, te Ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale ,

Pika 2 neni 77 te ligjit nr 162/2020 ku citohet: "Per sa i perket pershtatshmerise per te kryer nje veprimtari profesionale, autoritet ose entet kontraktore mund te kerkojne qe operoret ekonomike te regjistroheshen ne nje nga regjistrat profesionale ose tregetare.

Gjithashtu ky kriter eshte bazuar dhe ne nenin 21, 22 dhe 23 te Ligjit Nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekesore".

b) Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikate ISO 9001:2015, mbi "Sistemet e menaxhimit te cilesise ", dhe nese operatori ekonomik ofertues eshte prodhues i pajisjeve mjekesore duhet te paraqese certifikaten SSH EN ISO 13485:2016 " Sistemi i memaxhimit te cilesise per pajisjet mjekesore " ose EN ISO 13485:2016 mbi " Sistemin e menaxhimit te cilesise per pajisjet mjekesore " ose ekuivalent, per tregetim te pajisjeve mjekesore me objektin e prokurimit leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizimi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akredistuese te njohur nga Republika e Shqiperise. **Certifikata duhet te jete origjinale ose e**

perkethyer ne gjuhen shqipe e noterizuar, gjithashtu kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

c) Operatori ekonomik ofertues ne rastet kur nuk eshte prodhues i artikujve objekt prokurimi duhet te paraqese autodeklarate qe furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi eshte konform standarteve te cilesise ISO 90001:2015 “ Mbi sistemet e menaxhimit te cilesise “ ose EN ISO 13485:2016 “ Mbi sistemin e menaxhimit te cilesise per pajisjet mjekesore “ ose SSH EN ISO 13485:2016 “ Mbi sistemin e menaxhimit te cilesise per pajisjet mjekesore “ ,ose ekuivalent, te vlefshme , ne perputhje me objektin e prokurimit , leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë .**Certifikata duhet te jete origjinale ose e perkethyer ne gjuhen shqipe e noterizuar gjithashtu kerkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.**

AK rezervon te drejten per verifikimin e vetedeklarimit ne procesin e vleresimit te dokumentacionit, me kusht qe ne rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes se dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi : Kriteret e percaktuar ne piken b, dhe c, si me lart jane vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”,i ndryshuar ku percaktohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter eshte ne perputhje dhe me piken 1, te nenit 44, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Ky kriter është i lidhur ngushte me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës.Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”. Gjithashtu ISO 9001: 2015 perfaqeson standartin nderkombetar unanim i njohur si standarti qe i perket kerkesave per nje sistem manaxhimi te cilesise , specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, per një organizatë e cila duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve dhe të zbatueshme ligjore dhe rregullatore, dhe ka për qëllim të rrisë kënaqësinë e klientit përmes zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e konsumatorëve dhe kërkesat ligjore dhe rregullative).Të gjitha kërkesat e ISO 9001: 2015 janë të përgjithshme dhe kanë për qëllim të jenë të zbatueshme për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia, ose produktet dhe shërbimet që ofron. Ne rastin aktual eshte vendosur konform objektit te prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomike nuk mund të jete më e ulët se vlera e përlogaritur e kontrates.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-se, si dhe nenin 43, pika b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2/b, 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet:

Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Duke qenë se kjo procedure prokurimi është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar bazuar në vlerën e fondit limit, vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara se zoterojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK-ja.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,

afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, si dhe në nenin 40, pika 4, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më të vogël se 40 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është në përputhje me përcaktimet VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e Rregullave të Prokurimit Publik e Rregullave të Prokurimit Publik” nëni 40, pika 4: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më të vogël se 40 %** të vlerës së fondit limit.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të pakten 1 (një) inxhinier / (inxhinier biomedical/elektronik/informatik /elektrik) në stafin e vet të certifikuar /trajnuar për instalim dhe servis pajisjesh mjekësore objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave të trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK-se dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe në pikën 5/b/c të nenit 40, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohen të gjitha kriteret e mundshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me

natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Për këtë procedure objekti i prokurimit është: “Blerje dhe instalim i pajisjeve mjekesore per Spitalin Pogradec.Ky kriter konkretisht, është vendosur në mënyrë që e gjithë procedura të bëhet nga persona të kualifikuar të cilët garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrën e duhur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

2.3.3 Për të gjithë artikujt e kërkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (*Specifikimet teknike*) te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (*pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen*). Operatori ekonomik duhet te markoje me ngjyre te ndezur te verdhe ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me piken 6/b, të nenit 40, te VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku percaktohet se : 6. “*Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose* “ me qellim qe mallrat e furnizuar te jene konform standarteve dhe cilesise se kërkuar, kërkesa për dorëzimin e katalogëve të këtyre mallrave eshte një kërkesë e vendosur në kriteret e vecanta të kualifikimit, i shërben autoritetit për krijimin e një panorame të qartë mbi përpuethshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës me produktin/produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Paraqitja e katalogjeve per te gjithë artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kërkuar me qellim verifikimin e perpuethshmerise te specifikimeve teknike te pajisjeve mjekesore qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST .

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese **oferten teknike**, per pajisjet objekt prokurimi bashke me aksesoret perkates, ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut te pajisjes / produktit, nr. e faqes ku ndodhet produkti, numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.

Argumentimi:Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me **piken 1, te nenit 36, te ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**, te ndryshuar,ne te cilen eshte e percaktuar se: . *Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4, pika të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një process specifik për një faze tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi I të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në considerate kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu ky kriter është ne perputhje me piken 2, te nenit 40, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ku percaktohet se:2. *Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Ne kete kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me ane te se ciles do te behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve te ofertuar, specifikimeve te tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi.

2.3.5 Ofertuesi duhet te paraqese nje autodeklarate ku deklaron se pajisjet do te jene te shoqeruara me manualet e perdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualet e servisit/sherbimit.

Argumentimi: Kriteri është vendosur ne perputhje me nenin 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, ne pikat 6, dhe 8, te nenit 40, te VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“.Deklarata se pajisjet do te jene te shoqeruara me manualet e perdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualet e servisit/sherbimit, është kërkuar ne menyre qe pajisjet mjekesore te perdoren dhe te mirembahen nga stafi mjekesor sipas rekomandimeve te prodhuesit ne menyre qe te shmangen cdo lloj problematike qe mund te lind nga perdorimi ne menyre jo korrekte i ketyre pajisjeve.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributor zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (*ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin*), nëpërmjet te cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete original ose kopje e perkthyer ne gjuhen shqipe dhe noterizuar si dhe i vlefshem ne momentin e hapjes se ofertave.

Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK-se dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku percaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi, pasi ne rastin aktual kemi te bejme me aparatura specifike te nje natyre te vecante.

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me

produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues.

Ky kriter gjen mbështetje edhe në piken 2, të nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar .

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autodeklarate për pajisjet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorezimit të ofertave.

Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nënshkrimit të afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në funksion të cilësive të mallit të ofruar në përputhje me piken 1, të nenit 79, të Ligjit nr.162/2020”Për Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësive, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit ;*

Ky kriter vendoset në funksion të cilësive të mallit të ofruar në përputhje me piken 1, të nenit 44, të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësive, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit;*

Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për garantimin e cilësive të mallit dhe për përmbushjen me sukses të kontratës . Gjithashtu ky kriter është vendosur për arsye se diektiva CE ose FDA (SHBA) jep kërkesat thelbësore që janë të zbatueshme për instrumentet, aparatet dhe pajisjet, materialeve ose artikujve të tjerë që përdoren nga njerëzit me qëllim përcaktimin e diagnozës, parandalimit, monitorimit, kurimit apo lehtësimit së sëmundjes.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të leshojë një deklaratë për periudhën 12 mujore të garancisë së mallrave që kerkohen të prokurohen nga data e dorezimit të artikujve objekt prokurimi , gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë të defekteve

Argumentimi: Kërkesa për garancinë e produkteve të ofruara shërben për mbarëvajtjen e vendosjes së tyre në proces pune si dhe në identifikimin e problemeve të mundshme të trashëguara nga prodhuesi ose montuesit të pajisjeve si dhe në asistimin e cdo punonjësi që mund të ketë vështirësi në vënien në punë të pajisjes.

Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40, pika 8, e VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për furnizimet e mallrave/paisjeve mjekësore sipas afatit të përcaktuar në DST-te.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme (vetedeklarimet) janë përcaktuar për të vërtetuar që malli i ofruar përmbush kërkesat e AK-se dhe detyrimet ligjore perkatëse, bazuar në nenin **40, pika 8, te VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021** "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të konfirmoj vënien në punë të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme (vetedeklarimet) janë përcaktuar për të vërtetuar që malli i ofruar përmbush kërkesat e AK-se dhe detyrimet ligjore perkatëse, bazuar në nenin **40, pika 8, te VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021** "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

2.3.11 Pajisjet në momentin e furnizimit/dorëzimit duhet të jenë të pajisura me certifikaten e regjistrimit të pajisjes mjekësore nga AKBPM-ja, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Për këtë duhet të paraqesin deklaratë që garantojnë regjistrimin e tyre.

Argumentimi: Ky kriter është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 1/a të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, ”Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40, pika 8, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të Ligjit nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore”. E vetmja Agjenci Shtetërore e cila bën regjistrimin e pajisjeve mjekësore në Shqipëri është Agjencia e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për të cilën edhe njesia e prokurimit ka përcaktuar këto kriter i cili garanton këto përmbushje standartesh teknike etj., Njesia e prokurimit vendos kriterin e sipërcituar, në mënyrë që AK-ja të sigurohet që subjekti/shoqëria që do të kryej furnizimin dhe instalimin e pajisjeve mjekësore, të japë garancinë për këto paisje se do të bëhet regjistrimi pranë Agjencisë së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

2.3.12 Ofertuesi duhet të paraqesë deklaratë, ku deklaron se mallrat/pajisjet janë vendosur dhe ambalazhuar sipas standartit të prodhuesit, ku këto mallrat/pajisjet sipas objektit të prokurimit të jenë të reja, të papërdorura.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38, të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, në pikën 8, të nenit 40, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, ku deklaron se mer persiper trajnimin e stafit mjekësor për përdorimin e pajisjes në momentin e dorëzimit të saj.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.*

2.3.14 Operatori ekonomik duhet te vetedeklaroje origjinen e mallit dhe kompanine prodhuese ose distributorin e autorizuar. Te plotesohet ne shtojcen 2, Lista e cmimeve te artikujve ose te paraqese nje deklarate mbi origjinen e mallit (Firma prodhuese ose distributori i autorizuar dhe vendi i prodhimit/origjines,).

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” , ku percaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi, pasi ne rastin aktual kemi te bejme me aparatura mjekesore specifike dhe te nje natyre te vecante.*

Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në ligjin nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” i ndryshuar dhe njoftimit të përbashkët nr.25366.prot datë 30.12.2020 dhe nr.8480.prot datë 30.12.2020 të DPT-së dhe APP-së, ku shprehet se : prej datës 1 janar 2021 tatimpaguesit, të cilët kryejnë transaksione shitje me entet publike, kanë detyrimin ligjor të lëshojnë vetëm fatura elektronike për mallrat, punët apo shërbimet e shitura.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i punes i ngritur me urdher te brendshem nr.37/2 date 18 janar 2024 dhe jane vendosur ne perputhje nenit 4, pika 38/b dhe nenin 36, pika 1, te ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”te ndryshuar, ku percaktohet se :*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4, pika 38/b, të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e furnizimit te mallrave që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

Specifikimet teknike jane vendosur ne perputhje me nenin 40, pika 2, te VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku percaktohet se:*Për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”*

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. APARAT EKOGRAFIE ME DY SONDA (KONVEKSE DHE ENDOVAGINALE)

Aparat Ekografie me dy sonda (konvekse dhe endovaginale)

Te mundesoje metodat e imazhit:

B+B, B+B/C, B+B/PD, B+B/Blood Flow,

Te funksionojte ne kohe reale Real-Time Triplex Mode (Simultane/Njekohesisht) metodat:

B+C+PW, B+PD+PW, B+S-Flow+PW, B+TDI+TDW

Duplex dhe Triplex ne metodat:

B+C, B+M, B+3D, B+4D, B+PW, B+PD, B+S-Flow, B+CW, B+C+PW, B+C+CW, B+C+M,

B+ElastoScan, B+TDI, B+TDW

Ne Quad Mode te mundesoje:

Quad Mode

Combinations of B/B, B/C, B/PD and B/blood flow

Te kete opsionet Zoom Mode, Shenime ne Zoom Mode/ Read Zoom / Pen zoom/ Panning, Needle Mate Guide, Forma Trapezoide dhe Panoramike

Të punoje me tension 110V/220V, 50/60Hz (nese 110 te kete adaptor)

Të kete jo me pakse 3 porta aktive per sondat

Te kete Beamformer Te plote dixhital dhe Hibrit per performance me te larte me te pakten 286.000 kanale

Frenkuenca e aparatit te jete nga 2 deri me 15MHz

Te kete thellesi imazhi ne varesi te sondave nga 2cm deri me 37cm

Te kete minimum 8 pika fokusi te selektueshme

Te mundesoje minimum nje “ frame rate” prej jo me pakse 1.800 fps (Hz) dhe ne kolor jo me pakse 380 fps (hz)

Mundesi rrotullimi I imazhit ne 90-180-270o

Te kete Hard Disk me minimum 500Gb me kapacitet rruajtesh imazhesh jo me pakse 42.000 frames/60sec dhejo me pakse 12.000 ne “cineloop” ne te pakaten formatet AVI, MPEG, JPEG, BMP, TIFF, DICOM. Mundesi rruajtesh imazhesh prej minimum 320.000 imazhe ne formatin (.raw)

Te kete Raporte te editueshme ku mund te perfshihen imazhet dhe komentet e mjekut per printim ne leter A4.

Sistemi te kete mundesi te ndizet ne jo me shume se 4 minuta

Te kete minimumi 28 presete per perdorim abdominal, muskoseletal, gjinekologjik/obstetrical.

Monitori I aparatit te jete minimum 21 inch LED dhe me rezolucion minimum 1.920 x 1.080

Aparati te kete Touch Screen per lehtesimin e perdoruesit me dimensione jo me te vogla se 10 inch LED dhe me rezolucion jo me pak se 1.280 x 800, sikurse dhe menuja e touch screen te jete e editueshme.

Te kete tastier fizike sikur se dhe mundesine me prekje ne touch screen.

Te kete mundesi opsioni instalimi per te ardhmen te opsioneve Elsatografi, 3D/4D, Skanim

Panoramic, Matje automatike te IMT, Guide per Biopsi, STIC, DICOM, matje dhe pamje e folikulave 4D, sikurse dhe te mund te instalohen sonda 4D dhe Kardiologjike.

Video printer B&W te perfshire

Prodhimi vitit 2023-2024

Garancia te pakten 12 muaj

Sonda Endovaginale te kete parametrat e meposhtem:

Frekuence minimum nga 4 deri me 9MHz

Fushepamja prej 148o

Te mund te perdoret per minimum aplikacionet:Obsetri, Gjinekologji, Urologji

Sonda Konvekseduhet te kete parametrat e meposhtem:

Frekuenca e skanimit minimum nga 2 deri ne 8 MHz

Fushepamja minimum 56o

Numri minimal I elementeve te sondes 192 kristale

Te ketemundesit per kit biopsie nese do kerkohe

Te punoje ne aplikacionet Abdomen GjinekologjidheObsetri

Aparati duhet te kete mundesine e transferimit te imazheve tek aparatetAndroid ose IOS tek pacientet nepermjet WI-FI.

2. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE KABINETIT TE ENDOSKOPISE

VIDEO PROCESORI DHE BURIMI I DRITES

- Pajisja e videoprosesorit duhet te jetë Full HD dhe te jetë në një njësi të vetme me burimin e dritës së ftohtë LED. Pajisja duhet të ketë funksionin e zmadhimit të figurës.
- Pajisja duhet të ofrojë disa modalitete për përmirsimin e imazhit IEE, me anë të teknologjive (imazhe me ndricim blu, imazhe me ngjyra të lidhura dhe spekter fleksibel për përmirsimin e ngjyrave) për të ndihmuar doktorin në detektimin e polipeve, adenomave etj dhe në karakterizimin e sakte të tyre.
- Sistemi i këtyre tastierave specifike të tij dhe të ofrojë të paktën 3 butona për komanda të kontrolluara nga videoendoskopet, si psh freezing etj.
- Te këto të integruar modalitetin automatik për ruajtjen e të dhënave dhe procesori të jete gjithashtu kompatibel me DICOM.
- Në pjesën e pasme të pajisjes së videoprosesorit duhet të ketë dalje të broadcastit të dritës dhe 2 dalje DVI-D.
- Pajisja duhet të funksionojë në rryme elektrike me frekuencë 50/60 Hz, dhe voltazh 220-230 Volt.
- Burimi i ftohtë i dritës duhet të sigurojë ndriçimin minimalisht me 3 LED.
- Burimi i dritës duhet të ketë funksionin e rregullimit automatik të intensitetit të dritës (të rritjes dhe zvogëlimit) nëse largohet shumë nga indet ose nëse afrohet.
- Rregullimi manual i dritës duhet të jetë i mundur me burimin e ftohtë.
- Pajisja duhet të jetë e azhornueshme(upgradable) me pajisjen e inteligjencës artificiale e cila mund të detektojë anomalitë dhe të karakterizojë indin përkatës si neoplastik ose hiperplastik në real-time dhe në të njëjtin ekran ku doktori realizon procedurën endoskopike"
- Sistem kompjuterik për transferimin dhe arkivimin e imazheve dhe videove digjitale
- Duhet të ketë një pedal të dyfishtë për regjistrim dixhital të fotove dhe videove.
- Duhet të jetë në gjendje të bëjë foto ndërkohe që bën video.
- Duhet të ketë aftësinë të shikojë videot e regjistruara frame-by-frame dhe të regjistrojë imazhet nga secila frame.
- Garancia Te pakten 12 muaj

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PAJISJES VIDEOGASTROSKOPI HD

- Pajisja video gastroskop duhet të jetë e përshtatshme për përdorim diagnostikues dhe terapeutik dhe duhet të jetë HD (High Definition).
- Video gastroskopi duhet të ofroje teknologji te vecanta qe te perputhet me modalitetet e permirsimit te imazhit IEE (imazheve me ndricim blu, imazheve me ngjyra te lidhura dhe spekterit fleksibel te permirsimit e ngjyrave)
- Këndi i fushes se shikimit të video gastroskopit duhet të jetë te pakten 140 gradë.
- Thellësia e fushes se shikimit të video gastroskopit duhet të jetë midis 2-100 mm.
- Diametri i jashtëm i tubit të futjes së video gastroskopit duhet të jetë maksimumi 9.3 mm.
- Video gastroskopi duhet të ketë një diametër të jashtëm distal prej maksimumi 9.2 mm.
- Kanali i punës i video gastroskopit duhet të ketë një diametër të brendshëm prej te pakten 2.8 mm.
- Gjatësia e dobishme e punës së video gastroskopit duhet të jetë sa paku 1100 mm, dhe gjatësia totale duhet të jetë së paku 1.400 mm.
- Kapaciteti i lakimit të majës së videos gastroskopit duhet të jete lart deri ne 210 gradë, poshtë 90 gradë, djathtas 100 gradë, majtas 100 gradë.
- Butonat e ajrit / ujit dhe aspirimit të video gastroskopit duhet të jenë të këmbëshëm kur të konsumohen.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PAJISJES VIDEOKOLONOSKOPI HD

- Pajisja e video kolonoskopit duhet të jetë e përshtatshme për përdorim diagnostikues dhe terapeutik dhe duhet të jetë HD (High Definition).
- Video kolonoskopi duhet të ofroje teknologji te vecanta qe te perputhet me modalitetet e permirsimit te imazhit IEE (imazheve me ndricim blu, imazheve me ngjyra te lidhura dhe spekterit fleksibel te permirsimit e ngjyrave)
- Këndi i fushes se shikimit të videokolonoskopit duhet të jetë te pakten 170 gradë.
- Thellësia e fushes se shikimit te videokolonoskopit duhet të jetë midis 2-100 mm.
- Diametri i jashtëm i tubit të futjes së video kolonoskopit duhet të jetë maksimumi 12.8 mm.
- Diametri i jashtëm distal i video kolonoskopit duhet të jetë maksimumi 12.8 mm.
- Kanali i punës i video kolonoskopit duhet të ketë një diametër të brendshëm prej te pakten 3.8 mm.
- Gjatësia e dobishme e punës së video kolonoskopit duhet të jetë te pakten 1690 mm.
- Kapaciteti i lakimit të majës së video kolonoskopit duhet të jetë 180 gradë lart, 180 gradë poshte, djathtas 160 gradë, majtas 160 gradë.
- Skopi pervec kanalit uje/ajer te kete nje kanal te vecante per nxjerrjen e ujit me presion per pastrim nga papastertite dhe hemoragjite.
- Butonat e ajrit / ujit dhe aspirimit të video duhet të jenë të këmbëshëm kur konsumohen.

Njesi Regjistrimi

- Modul me komandim me pedale per regjistrim e imazheve dhe video imazheve me kapacitet 1TB

AKSESORE TE TJERE TE SISTEMIT ENDOSKOPIK QE DUHET TE JENE TE PERFSHIRE:

1. Monitori i sistemit

- duhet të jetë i teknologjise LED. te pakten 27 inç dhe me rezolucion të imazhit të paktën 1920x1080 piksel. Monitori duhet të ketë hyrje DVI.

2. Karreli

- Në karrelin e propozuar të transportit te sistemit, të gjitha kabllot e lidhjeve elektrike duhet të jenë në gjendje të fiksohen në një seksion.
- Sistemi duhet të jetë i aftë të lidhet në rrjetin e ushqimit me një kablo të vetme lidhëse.
- Ai duhet të jetë në gjendje të mbajë mbi vete procesorin me burimin e Dritës, si dhe Monitorin e kerkuar
- Duhet të jetë në gjendje të mbajë të paktën dy endoskope në të dhe për këtë, duhet të ketë një varëse mbajtëse në karrelin transportues.
- Të paktën dy rrota duhet të kenë mekanizëm bllokimi.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit

1-Sefer Xhyra, Anetar,Pergjegjes per prokurimin _____

2-Rexhina Adri, Antar, Jurist_____

3-Anhela Kuqo, Antar, Ekonomiste e finances_____